VENDIM
Nr. 17, datë 5.11.2021

BIBLIOGRAFIA E INFORMACIONIT TË DEKLASIFIKUAR NË AIDSSH

Bazuar në ligjin nr. 8457, datë 11.2.1999, "Për informacionin e klasifikuar 'Sekret shtetëror"', të ndryshuar, kreu III, neni 13, pika "b"; në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 662, datë 15.11.2017, "Për miratimin e rregullores për deklasifikimin dhe zhvlerësimin e informacionit të klasifikuar 'sekret shtetëror', kreu II, neni 4, pika "a", "c"; dhe në udhëzimin nr. 99, datë 13.4.2018, "Për zbatimin e vendimit nr. 662, datë 15.11.2017, për deklasifikimin dhe zhvlerësimin e informacionit të klasifikuar 'Sekret shtetëror"', Komisioni i Deklasifikimit dhe Zhvlerësimit të Informacionit të Klasifikuar "Sekret shtetëror", në AIDSSH, i ngritur me urdhër nr. 13, datë 3.5.2018 të kryetarit të Autoritetit, "Për krijimin e Komisionit të Deklasifikimit dhe Zhvlerësimit të Informacionit të Klasifikuar 'Sekret shtetëror', të ndryshuar në AIDSSH", ka bërë deklasifikimin e informacionit të klasifikuar "Sekret shtetëror", me vendimin nr. 17, datë 5.11.2021, si më poshtë:

I. Deklasifikoi plotësisht informacionet e mëposhtme:

1. Fletore shënimesh nr. 28, datë 8.11.1985, në ngarkim të A.M., me 80 (tetëdhjetë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Sekret". Fletorja i përket fondit ish-Ushtria.

2. Fletore shënimesh nr. 54, datë 7.2.1986, në ngarkim të A.M., me 120 (njëqind e njëzet) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Sekret". Fletorja i përket fondit ish-Ushtria.

3. Fletore shënimesh nr. 20, datë 29.10.1985, në ngarkim të A.M., me 74 (shtatëdhjetë e katër) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Sekret". Fletorja i përket fondit ish-Ushtria.

4. Dosje gatishmërie e sigurimit të repartit nr. 5845 Fier, me nr. 42, në ngarkim të A.M., me 13 (trembëdhjetë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Sekret i rëndësisë së veçantë". Dosja i përket fondit ish-Ushtria.

5. Dosje e informatave nr. 62, në ngarkim të A.M., me 23 (njëzet e tre) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Sekret". Dosja i përket fondit ish-Ushtria.

6. Fashikull nr. 1 nga dosja e objektit nr. 6, në ngarkim të A.M., me 35(tridhjetë e pesë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Sekret". Fashikulli i përket fondit ish-Ushtria.

7. Vendim i Sigurimit të Repartit Ushtarak nr. 6561, nr. 147, datë 23.12.1989, për heqjen nga rrjeti informativ të bashkëpunëtorit "skifteri" dhe veçimi i dosjes për asgjësim, me 1 (një) fletë. Niveli i klasifikimit është "Sekret A. Res. Personal". Dokumenti i përket fondit ish-Dega e Punëve të Brendshme Lushnjë.

KRYETAR I KOMISIONIT
TË DEKLASIFIKIMIT DHE ZHVLERËSIMIT
Gentiana Sula